



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT

5475  
Nr. ... Prot.

Tiranë, më 30.05.2016  
(Lutemi referojuni në rast përgjigje)

MARRËVESHJE

PËR OFRIMIN E TESTEVE TË NJOHURA NDËRKOMBËTARISHT TË GJUHËS  
ANGLEZE

Bazuar në pikën 2 të nenit 75, në pikën 4 të nenit 76 dhe pikës 3 të nenit 78 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimin nr. 52, datë 03.12.2015 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë”; për ofrimin e testit të njohur ndërkombëtarisht në Republikën e Shqipërisë: “Cambridge”, ku

**Ministria e Arsimit dhe Sporteve** (këtej e në vijim MAS), përfaqësuar nga Z. Plarent Ndreca, Sekretar i Përgjithshëm, me adresë: Rruga e Durrësit, nr. 23, 1001 Tiranë,

Dhe:

**Personit Juridik “English Cultural Institute” sh.p.k**, përfaqësuar nga znj. Sleida Bushati, me nr. NIPT-I (SSN): L51308010F, me adresë: Rruga “Pashko Vasa” Tiranë, e autorizuar nga **Cambridge English**, pjesë e Universitetit të Cambridge, sipas marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet tyre më datë 12 Shkurt 2015, për ofrimin e testit të “Cambridge” në territorin e Republikës së Shqipërisë, më poshtë referuar si “Palët”,

Bien dakort, për sa më poshtë:

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Qëllimi i kësaj marrëveshje është ofrimi i testit të njohur ndërkombëtarisht të gjuhës angleze: “Cambridge”, në territorin e Republikës së Shqipërisë, shkëmbimin e informacionit në lidhje me testimet ndërkombëtare, si dhe ofrimin e të dhënave për të gjithë kandidatët që aplikojnë në IAL-të për programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë.

**Neni 2**  
**Objekti**

Objekti i kësaj marrëveshjeje është përcaktimi i procedurës dhe vendosja e rregullave të ofrimit të shërbimit dhe bashkëpunimit mes palëve, në mënyrë që të sigurohet:

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Nr. 23, AL 1001, Tiranë

Web site: [www.arsimi.gov.al](http://www.arsimi.gov.al)



- a) ofrimi i testit ndërkombëtar të gjuhës angleze, për Cambridge PET, FCE dhe CAE, për aplikantët në programet e studimit të ciklit të dytë: “Master i shkencave” dhe “Master i Arteve”.
- b) ofrimi i testeve ndërkombëtare të gjuhës angleze, për Cambridge CAE, për aplikantët në programet e studimit të ciklit të tretë: “Master ekzekutiv”, “Studime Specializuese Afatgjata”, si dhe “Doktoratë”;
- c) Pajisja me dëshminë e njohjes së gjuhës së huaj, sipas formatit standard të njohur ndërkombëtarisht për testin në fjalë dhe të depozituara nga subjekti paraprakisht.

### Neni 3

#### Të drejtat dhe detyrimet e ofruesit të shërbimit

#### 3.1 “English Cultural Institute” sh.p.k, ka të drejtë:

- a) Të ofrojë testin e gjuhës angleze: “Cambridge”, në territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas objektit të kësaj marrëveshje dhe niveleve të përcaktuara në udhëzimin përkatës;
- b) Të lëshojë dokumentin e njohjes së gjuhës së huaj, sipas përcaktimeve në këtë marrëveshje;
- c) Testet e ofruara kanë vlefshmëri lidhur me objektin e përcaktuar në këtë marrëveshje sipas përcaktimeve të pikës 4 të udhëzimit të sipërcituar.

#### 3.2 “English Cultural Institute” sh.p.k, ka për detyrë:

- a) Të ushtrojë veprimtarinë e saj, duke garantuar mirëfunksionimin, transparencën dhe ligjshmërinë në ofrimin e këtij shërbimi;
- b) Të administrojë bazën e të dhënave në format hard copy dhe elektronik, të aplikantëve të testuar dhe të çertifikuar.
- c) Të administrojë regjistrin e dëshmimeve të njohjes së gjuhës, të lëshuara për aplikantët;
- d) Të ofrojë MAS dhe IAL-ve të gjithë informacionet e kërkuara lidhur me këtë veprimtari;
- e) Të garantojë mbrojtjen e të dhënave personale të aplikantëve, sipas kuadrit ligjor në fuqi;
- f) Të respektojë kuadrin ligjor në fuqi, lidhur me të gjithë veprimtarinë e saj në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- g) Brenda 15 ditëve, pas nënshkrimit të kësaj marrëveshje, subjekti duhet të depozitojë në MAS, formatin e dëshmisë sipas atij të miratuar nga kompania mëmë, titullari i të drejtës intelektuale.

### Neni 4

#### Të drejtat dhe detyrimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit

MAS, ka këto të drejta dhe detyrime:

- a) Të monitorojë veprimtarinë e subjektit, lidhur me përmbushjen e detyrimeve sipas kësaj marrëveshje;
- b) Të kërkojë prishjen e njëanshme të marrëveshjes, në rast mosrespektimi të detyrimeve të përcaktuara në këtë marrëveshje;
- c) Të kontaktojë me përfaqësinë diplomatike përkatëse, në territorin e RSh, për të konfirmuar të drejtën e pronësisë intelektuale të subjektit dhe performancën e ofruesit të testit;
- d) Të garantojë mbrojtjen e të dhënave personale të përcjella nga subjekti konform legjislacionit në fuqi.

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Nr. 23, AL 1001, Tiranë

Web site: [www.arsimi.gov.al](http://www.arsimi.gov.al)



**Neni 5**  
**Mbrojtja e të dhënave personale dhe konfidencialiteti**

Palët angazhohen që në asnjë rast, të dhënat e shkëmbyera midis tyre, nuk do të çenojnë apo të bien ndesh me konventat ndërkombëtare dhe legjislacionin kombëtar në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe konfidencialitetin.

**Neni 6**  
**Ndryshimi marrëveshjes dhe ndërprerja e saj**

- 6.1 Kjo marrëveshje mund të jetë objekt i ndryshimeve të nevojshme, me kërkesën e njëres prej palëve, që bëjnë pjesë në të.
- 6.2 Ndryshimet në këtë marrëveshje bëhen vetëm me shkrim ndërmjet palëve dhe hyjnë në fuqi pas miratimit të tyre nga palët.

**Neni 7**  
**Ndërprerja e marrëveshjes**

- 7.1 Kjo marrëveshje ndërpritet nga MAS me efekt të menjëhershëm, nëse nuk respektohen detyrimet dhe parashikimet e kësaj marrëveshje nga subjekti ofrues i testimit.
- 7.2 Kjo marrëveshje ndërpritet me efekt të menjëhershëm, nëse pas verifikimit të bërë nga MAS, pranë institucioneve kompetente apo përfaqësive të huaja diplomatike, rezulton se subjekti nuk ka të drejtën e pronësisë intelektuale për të ofruar testin e gjuhës së huaj në territorin e RSH.
- 7.3 Kjo marrëveshje mund të ndërpritet, vetëm me njoftim me shkrim ndërmjet palëve, si pasojë e ndryshimeve të kuadrit ligjor në fuqi, apo mosrespektimit të saj nga palët.
- 7.4 Ndërprerja e marrëveshjes, duhet të bëhet publike nga palët, si dhe informohet me shkrim subjekti titullar i të drejtës së pronësisë intelektuale për ofrimin e testeve në territorin e Republikës së Shqipërisë.

**Neni 8**  
**Hyrja në fuqi dhe Afati**

- 8.1 Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga përfaqësuesit e të dy palëve.
- 8.2 Kjo marrëveshje hartohet në gjuhën shqipe në katër kopje origjinale dhe ka një afat deri në dy vjet nga hyrja në fuqi e saj.

NËNSHKRUAR, sot më 30/05 /2016, në Tiranë.

Për Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve

.....  
*Plarant Molicu*

Emer Mbiemri  
Firma

Vula



Për "English Cultural Institute"

*Blenda Bushati*

Emer Mbiemri  
Firma

Vula



ENGLISH CULTURAL INSTITUTE  
Rruga: "Pashko Vasa" Tirana Albania  
Tel: 00355 42272858

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Nr. 23, AL 1001, Tiranë

Web site: [www.arsimi.gov.al](http://www.arsimi.gov.al)